



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.02.2023)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:37 dhe mbaroi në orën 14:14.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Maela Alicanaj, Këshilltare Ligjore pranë Njësisë Mbështetëse pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3. Denisa Varfi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Çështja e cila është për trajtim, sipas njoftimit të bërë ditën e sotme, në rendin e ditës datë 09.02.2023, ora 13:30, lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, për të relatuar relacionet e përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Merr fjalën zoti Kurushi për të vijuar me relatimin e të gjitha relacioneve për secilën nga kërkesat e paraqitura nga gjykatat që janë në nevojë.

Fillimisht propozohet radha e procedurave të shortit sipas kësaj radhe:

Gjykatat e shkallës së parë, sipas kësaj radhe:

Gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm:

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë.
2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.
3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë;
4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë.
5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Gjykatat e apelit – Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Pasi anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime me radhën e procedurave të shortit, vijohet me relatimin e relacioneve përkatëse.

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë** ajo ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohen procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Për çështjen e parë kërkohet caktimi i 1 (një) gjyqtari për gjykimin e çështjes penale me të pandehur {...}, {...} etj. Trupi gjykues përbëhet nga {...} dhe {...}. {...} ka gjykuar kërkesën për zëvendësim mase sigurimi. {...} gjyqtare e hetimit paraprak.

Për çështjen e dytë kërkohet caktimi i 1 (një) gjyqtari për gjykimin e çështjes penale me të pandehur {...} etj. Trupi gjykues përbëhet nga {...} dhe {...}. Znj. {...} ka gjykuar kërkesën për revokim mase sigurimi në fazën e seancës paraprake. Znj. {...} gjyqtare e hetimit paraprak.

Për çështjen e tretë kërkohet caktimi i 1 (një) gjyqtari për gjykimin e kërkesës penale me objekt “Zëvendësim mase mjekësore” të shtetasit {...}. Nga KLGJ më parë është caktuar z. {...} për gjykimin e kërkesës për caktim mase mjekësore ndaj këtij shtetasi. Në përputhje me parashikimet e Nenit 46 të K. Penal – që parashikon se: “Vendimi gjyqësor për masat mjekësore dhe edukuese është i revokueshëm në çdo kohë kur zhduken rrethanat për të cilat ai është dhënë, por në çdo rast, gjykata, kryesisht, është e detyruar që pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së vendimit, të marrë në shqyrtim vendimin e saj. Rregullat për revokimin e vendimit gjyqësor që përmbajnë masa mjekësore parashikohen në Kodin e Procedurës Penale...”, kjo kërkesë duhet të shqyrtohet nga i njëjti trup gjykues që ka shqyrtuar kërkesën si më lart.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 3 (tre) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 (tre) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1 (një).

Për çështjen gjyqësore me numrin rendor 3 në tabelë, në përputhje me nenin 46 të K.Penal dhe vendimit nr. 554, datë 29.12.2022 të KLGJ-së “Për ndarjen me short të çështjeve

gjqësore”, seksioni IV, pika 1, germa “e”, kjo kërkesë duhet të shqyrtohet nga i njëjti trup gjykues, pra gjyqtari {...}, që ka shqyrtuar kërkesën e parë.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, në ndryshim nga rregulli i përgjithshëm të mos përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, konkretisht: Z. Artan Çupi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtar Murat Lleshi.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtar Murat Lleshi.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtar Artan Çupi.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec** ajo ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohen procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Për çështjen e parë kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Më parë nga KLGJ është caktuar gjyqtari {...} për gjykimin e kërkesës me objekt – Dërgim për gjyq, i cili ka dhënë dorëheqjen pasi është anëtar i trupit gjykues në procedimin e lidhur me të pandehur {...}. Kjo kërkesë është miratuar nga zv/kryetari i gjykatës. Gjyqtare {...} ka shqyrtuar kërkesën në fazën e hetimeve paraprake për caktim mase sigurimi. Gjyqtari {...} ka shqyrtuar kërkesat gjatë fazës së hetimeve paraprake për lejim përgjimi etj. Kanë pengesë gjithashtu edhe znj. {...} dhe z. {...} pasi janë anëtarë të trupit gjykues në çështjen e bashkë të pandehurve.

Për çështjen e dytë kërkohet caktimi i 3(tre) gjyqtarëve në çështjen me të pandehur {...}. Për procedimin e ndarë janë caktuar nga KLGJ-ja anëtarë të trupit gjykues: znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}. Kanë pengesë znj. {...} dhe z. {...}.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3 (tre).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, në ndryshim nga rregulli i përgjithshëm të mos përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, konkretisht: z. Besnik Shehu. Propozimi lidhet me faktin se disa gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë të përmendur më lartë janë aktualisht pjesë e trupave gjykues që gjykojnë procedime të ndara të cilat lidhet me dy çështjet penale për të cilat është kërkuar plotësimi i trupit gjykues, si dhe fakti që numri i gjyqtarëve që kërkohet të caktohet për të plotësuar trupat gjykues për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec është numri tre. Kjo është arsyeja që z. Shehu propozohet të jetë pjesë e shortit.

Në shortin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që kanë pengesë ligjore sipas relacionit.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Besnik Shehu.

Për çështjen nr. 2, penale ardhur me e-mail, gjyqtarët relator Thomaidha Roça, Eglantina Mikani dhe Besnik Shehu (anëtarë).

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë** ajo ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohen procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Për çështjen e parë kërkohet caktimi i 1 (një) gjyqtari për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të pandehurit {...}. Trupi gjykues përbëhet nga {...} dhe {...}. Gjyqtari {...} ka qenë gjyqtar i hetimeve paraprake;

Për çështjen e dytë kërkohet caktimi i 1 (një) gjyqtari për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të pandehurit {...}. Trupi gjykues përbëhet nga znj. {...} dhe z. {...}. Gjyqtari {...} ka qenë gjyqtar i seancës paraprake.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i

nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata, nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, në ndryshim nga rregulli i përgjithshëm të mos përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, konkretisht: z. Aurel Arapi.

Në shortimin e çështjes, të përjashtohet nga shorti për shkaqe shëndetësore gjyqtari i gjykatës së rrethit gjyqësor Kurbin, z. {...}; si edhe znj. {...}, për shkak të ngarkesës që ka e caktuar nga KLGJ për plotësimin e trupit gjyqësor, me një ngarkesë prej 15 çështjesh si e caktuar si anëtare.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1 dhe 2 penale, gjyqtar Olti Skrame.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë** ajo ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes që do t'i nënshtrohet procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Kërkohej caktimi 2 (dy) gjyqtarëve, për çështjen me të pandehur {...}. Gjyqtare {...} ka gjykuar kërkesën e prokurorisë për caktim mase sigurimi; Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtari z. {...}. Nuk rezultojnë gjyqtarë të tjerë të cilët kanë pengesa të dukshme nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nga ku do propozohen gjyqtarët e mundshëm dhe të gatshëm për të plotësuar trupin gjykues për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata, nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër (seksioni penal).

Numri i gjyqtarëve që duhen të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2 (dy).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, në ndryshim nga rregulli i përgjithshëm, të mos përjashtohet nga shorti zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi do të bëhej i pamundur përdorimi i mekanizmit të shortit, konkretisht z. {...}. Arsyeja pse propozohet të mos përjashtohet z. Shehu është pasi seksioni penal përbëhet nga tre gjyqtarë z. {...}, z. {...} dhe z. {...}. Nëse do përjashtohet zoti Shehu, atëherë mekanizmi i shortit do të bëhej i pamundur, pasi dy gjyqtarët e tjerë të seksionit penal automatikisht do të ishin pjesë e trupit gjykues.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Besmir Stroka dhe Sokol Shehu.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet** ajo ka paraqitur nevojë për 16 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohen procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Për çështjet me numër rendor nga 1-3, 6, 10, 11, 12, 13 gjyqtarja znj. {...} është gjyqtare e hetimit paraprak. Për çështje me numër rendor 4, 7, 8, 9, 14 gjyqtarja znj. {...} është gjyqtare e seancës paraprake. Për çështjen me numër rendor 5, gjyqtarët {...} dhe {...} janë gjyqtarë të hetimit paraprak. Për çështjen me numër rendor 15 gjyqtarja {...} është gjyqtare e seancës paraprake, ndërsa gjyqtarja {...} është gjyqtare e hetimit paraprak. Për çështjen me numër rendor 16 gjyqtari {...} ka qenë më parë në përbërje të trupit gjykues. Trupi gjykues përbëhet nga znj. {...} dhe z. {...}.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 16 (gjashtëmbëdhjetë) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 16 (gjashtëmbëdhjetë) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3 (tre).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, në ndryshim nga rregulli i zakonshëm të mos përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, konkretisht: znj. Suela Dashi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 16, penale, gjyqtari Gjergji Baçi. (kërkesa 12)

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtari Arben Dosti. (çështja nr. 187)

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Suela Dashi. (çështja nr. 118)

Për çështjen nr. 11, penale, gjyqtari Arben Dosti. (çështja nr. 171)

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtarja Suela Dashi. (çështja nr. 146)

Për çështjen nr. 8, penale, gjyqtari Gjergji Baçi. (çështja nr. 167)

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Arben Dosti. (çështja nr. 169)

Për çështjen nr. 10, penale, gjyqtarja Suela Dashi. (çështja nr. 191)

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtari Gjergji Baçi. (çështja nr. 60)

Për çështjen nr. 12, penale, gjyqtari Arben Dosti. (çështja nr. 170)

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Suela Dashi. (çështja nr. 67)

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtari Gjergji Baçi. (çështja nr. 184)

Për çështjen nr. 13, penale, gjyqtari Arben Dosti. (çështja nr. 76)

Për çështjen nr. 14, penale, gjyqtarja Suela Dashi. (çështja nr. 9)

Për çështjen nr. 9, penale, gjyqtari Gjergji Baçi. (çështja nr. 177)

Për çështjen nr. 15, penale, gjyqtarët Arben Dosti (relator), Suela Dashi dhe Gjergji Baçi anëtarë. (çështja nr. 214)

Vijohet me kërkesën e ardhur nga **Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**, e cila ka paraqitur nevojë në 1 çështje, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes që do t'i nënshtrohet procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Trupi gjykues përbëhet nga z. {...} relator dhe znj. {...} anëtare. Kanë pengesë gjyqtarët e gjykatës së posaçme të apelit pasi kanë gjykuar të bashkëpandehurit e tjerë në një procedim të lidhur. Kanë pengesë gjithashtu edhe gjyqtarët znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, të cilët po gjykojnë të pandehurit të tjerë në një procedim të lidhur.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhet gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat me juridiksion të përgjithshëm dhe gjyqtari të përzgjidhet, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Bashkëlidhur relacionit është edhe lista e gjyqtarëve të gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret e lartpërmendura. Gjyqtarët që Komisioni propozon që të përfshihen në short janë: znj. Vojsava Osmanaj, znj. Alma Ahmeti, znj. Irida Kacerja, znj. Ornela Naqellari, znj. Edlira Petri, znj. Miranda Andoni, znj. Emona Muçi, znj. Elona Toro.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik për zgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Elona Toro.

Me përfundimin e shortit, mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor